

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sekuestrohen 20 kg drogë në Austri, dy të arrestuar, mes tyre një shqiptar
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/sekuestrohen-20-kg--ne-austri-dy-te-arrestuar-mes-tyre-nj-e-shqip-i104308
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 19:00:19 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 18:50:41 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	3bb5a07f5b89dafa2024825c5b41860d2d1390bea6921db1a6349bbc266b5307
TEKSTI	808d52703f426a23910fd3de9e31c17570f431aa0e35235d4991c4c2bd8731ad
PAMJA	c049abf1d2315503799a8ba9e14bcf96bab95d6e66900cb23b7763327fba4834

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	99059c37405a0642ddb7705c6cc6fc7e019514c31f46aa7501703da9f3cf6fc8
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7fc79e204ff2dfa3f9e677f0c9d1bacea0122705418ff355483188747d3235b5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/99059c37405a0642ddb7705c6cc6fc7e019514c31f46aa7501703da9f3cf6fc8>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **Saudite anulon dërgesat** për klientët evropianë, të **rasti i dajës së Zegjine** "Pranisë Besnike", kryeministri **vendoset edhe për pagat e** ndryshime në përbërjen e **shqiptare është e furnizuar** Ledi, ushtria shqiptare sot **me lehtësira fiskale** Demokratike kërkon nga qeveria që të lehtësojë

[AKTUALITET](#)

Sekuestrohen 20 kg drogë në Austri, dy të arrestuar, mes tyre një shqiptar

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 20:50



Policia austriake ka arrestuar dy persona të dyshuar për trafik droge në Vjenë, një 32-vjeçar austriak dhe një 37-vjeçar shqiptar.

Sipas mediave të huaja, operacioni është zhvilluar në zonën e Leopoldstadt, pas nisjes së një hetimi ndaj 37-vjeçarit shqiptar, i cili kishte tërhequr vëmendjen e policisë për shkak të sjelljes së dyshimtë.

Efektivët e vendosën atë nën vëzhgim dhe më pas konstatuan një takim me 32-vjeçarin austriak. Gjatë takimit, shqiptari vendosi një çantë shpine në automjetin e 32-vjeçarit.

Policia ndërhyri dhe kontrolloi automjetin, ku gjeti më shumë se 1 kilogram kanabis. Pak më vonë, efektivët ndaluan edhe automjetin e 37-vjeçarit shqiptar, i cili u arrestua pavarësisht rezistencës gjatë ndërhyrjes.

Hetimi vijoi me kontrolle në dy apartamente, ku policia zbuloi sasi të tjera të konsiderueshme droge. Në total u sekuestruan rreth 17 kilogramë marihuanë, 1.5 kilogramë kokainë dhe 60 gramë Crystal Meth.

Gjatë operacionit u sekuestruan gjithashtu disa telefona celularë dhe rreth 160 euro cash.

Sipas autoriteteve austriake, dy të arrestuarit dyshohen se janë të përfshirë në aktivitetin e shpërndarjes së lëndëve narkotike. Hetimet vijojnë për të përcaktuar rolin e secilit prej tyre dhe për të zbardhur nëse pas sasisë së sekuestruar qëndron një rrjet më i gjerë i trafikut të drogës.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 15 Shtator20:10

[“Me ç’fytirë pushtetit i ngjitesh?”/ Protestuesit ironizojnë Ramën me pankarta në ditën e 108-të](#)

Protesta e 108-të kundër qeverisë së Edi Ramës është shoqëruar edhe këtë herë me pankarta me mesazhe iron...

AKTUALITET 15 Shtator19:43

[Rama paralajmëroi masa për ndërhyrje në punësime, rasti i dajës së Zegjine Çaushit ngre pikëpyetje: A do të veprojë kryeministri?](#)

Vetëm një javë më parë, në kuadër të “Pranisë Besnike”, kryeministri Edi Rama u përcolli deputet&e...

AKTUALITET 15 Shtator19:17

[“Nuk jam ndjerë i shantazhuar, s’kam rrjete sociale”. gjyqtari Engert Pëllumbi i përgjigjet deputetëve. Manja: Paskë rënë rehat](#)

Kryetari i Shoqatës së Gjyqtarëve dhe gjyqtar në Apelin e Gjykatës së Posaçme, Engert Pëllumbi u është p&eum...

Lirimi i Parkut të Liqenit nga ndërtimet pa leje, Bashkia e Tiranës aksion për prishjen e godinës shumëkatëshe

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit i Bashkisë së Tiranës ka prishur sot një objekt katërkatësh pa leje në zonën...

AKTUALITET 15 Shtator18:46

Policia rrugore shqëron kamionët e “Alesio-2014” në orarin e ndalimit të qarkullimit

Një situatë skandaloze është fotografuar pasditen e kësaj të marte, (15 shtator 2026) në zonën e Unazës së Vog...

AKTUALITET 15 Shtator18:21

Zjarr i përmasave të mëdha në fshatin “Andon Poçi” në Gjirokastrë, zjarrfikësit vënë nën kontroll flakët

Një zjarr ka përfshirë pasditen e sotme një sipërfaqe me shkurre dhe kallamishte në hyrje të fshatit Andon Poçi, në...

AKTUALITET 15 Shtator18:11

Atentati i dështuar ndaj Gazmir Dacit/ Ishte dënuar me 20 vite burg, Gjykata e Lartë kthen për rigjykim çështjen e Ergys Kolaverit

Gjykata e Lartë ka prishur vendimin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për çështjen e Erg...

AKTUALITET 15 Shtator17:19

Aksident në aksin rrugor Lezhë-Shkodër, përplasen 3 automjete! 3 persona të plagosur

Aksident me tre automjete, në afërsi të kryqëzimit të Gocajve, përgjatë superstradës Lezhë-Shkodër. Përpl...

AKTUALITET 15 Shtator16:58

Aksident i rëndë në Dibër, plagosen 5 persona, 4 prej tyre nisen drejt Tiranës

Një aksident rrugor është regjistruar në aksin nacional Maqellarë–Peshkopi, ku kanë mbetur të plagosur 5 persona. Të...

AKTUALITET 15 Shtator16:30

Zjarr në një fshat në Gjirokastrë, rrezikohen banesat

Në hyrje të fshatit Andon Poçi ka rënë një zjarr i përmasave të mëdha, i cili për shkak të përhapj...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 15 Shtator

Sulmohet Arabia Saudite, bombardohet me raketa ...

Huthët e Jemenit, të mbështetur nga Irani, kanë nisur një valë të re sulmesh ndaj Arabisë Saudite, ndërsa paralel...

BOTA 14 Shtator

“E drog*va dhe abuz*va gruan për 20 vite”/ Bash...

Një burrë britanik pranoi sot se kishte droguar dhe përdhunuar gruan e tij në shtëpinë e tyre për rreth dy dekada. Burri, ban...

AKTUALITET 15 Shtator

Rrëfihet 34-vjeçarja: Daja i Zegjine Caushit më...

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak ditë më parë në Roskovec, ku Bledar Bakaj shkoi në shtëpinë e ish-bashkë...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.